

Detyra e muslimanit karshi gabimeve të vëllezërve të tij



nga shejkh

'ABDUS-SELAM IBËN BERXHES

 **Selefi.org**
Kurani dhe Suneti sipas kuptimit të Selefëve të këtij Umeti

**Detyra e muslimanit karshi gabimeve
të vëllezërve të tij.**

Ligjeratë e Shejkhut të nderuar:

Abdus-Selam ibën Berxhes Ali Abdul-Kerim

(Allahu i Lartësuar e mëshiroftë)

Hutbeja e parë:

Me të vërtetë lavdërimi i takon Allahut, Atë e falenderojmë, ndihmë dhe falje Atij i kërkojmë, si dhe tek Ai pendohemi. I kërkojmë mbrojtje Allahut nga dëmet e veteve tona dhe nga e keqja e punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu, s'ka kush ta humb ndërsa atë që Ai e humb, s'ka kush ta udhëzojë.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, i Vetëm pa ortak, si dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij. Lëvdata dhe shpëtimi i madh i Allahut qoftë mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij deri Ditën e Gjykimit.

E më pas:

O ju besimtarë! Frikësojuni Allahut – të *Plotfuqishëm e të Madhëruar* – me një frikë të vërtetë, dhe mos vdisni vetëm se duke qenë muslimanë.

Robër të Allahut! Me të vërtetë, vëllazëria në fenë e Allahut – të *Plotfuqishëm e të Madhëruar* – është një lidhje e fortë midis besimtarëve. Ata janë vëllezer në fenë e Allahut – të *Plotfuqishëm e të Madhëruar* –, ata i bashkon ky iman (besim) dhe takohen për hir të tij si dhe bashkohen nën flamurin e tij. Kështu që, ata janë vëllezër edhe pse janë larg njëri-tjetrit, edhe pse vendet e tyre dallojnë dhe ngjyrat e tyre ndryshojnë. Besimtari do për vëllain e tij besimtar atë që do për veten e tij. E si jo?! Kur Allahu – i *Plotfuqishëm e i Madhëruar* – e ka vendosur vëllain tënd musliman në pozitën e vetes tënde. Ka thënë Allahu i Lartmadhëruar:

وَلَا تَلْمِزُوا أَنْفُسَكُمْ

“E mos i shani vetet tuaja”.¹

D.m.th. vëllezërit tuaj!

¹ El-Huxhurat, 11.

Me të vërtetë, kjo lidhje midis muslimanëve është një lidhje me të cilin Allahu na ka begatuar, na ka nderuar dhe na ka respektuar. Vërtet Allahu i ka begatuar besimtarët me këtë vëllazëri besimtare, si dhe i ka përmendur me të:

وَاذْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنْتُمْ أَعْدَاءً فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ بِنِعْمَتِهِ إِخْوَانًا

“Dhe përkujtoni mirësinë e Allahut mbi juve kur ju ishit armiq, dhe Ai i bashkoi zemrat tuaja, kështu ju u bëtë me mirësinë e Tij vëllazër”.²

E me të vërtetë, dobësia që ka filluar të përhapet tek muslimanët, është vetëm për shkak të neglizhimit të të drejtave të kësaj vëllazërie, si dhe për shkak të dobësisë së kryerjes së saj me të cilën na obligoi Allahu karshi saj. Kështu që, fuqia e muslimanëve nuk do të jetë vetëm se me iman (besim), ndërsa besimi nuk do të jetë vetëm se me “Lidhjen më të fortë”, dhe ajo është dashuria për hir të Allahut dhe urrejtja për hir të Allahut.

Dhe me të vërtetë, disa muslimanë – Allahu i Plotfuqishëm e i Madhëruar i udhëzofte – nuk mjaftohen me këtë neglizhencë ndaj të drejtave të kësaj vëllazërie besimtare, madje kësaj i është shtuar një mëkat i qartë, e ai është bashkangjitja e dëmit vëllazërve të tij muslimanë me çfarëdo lloj prej llojeve të dëmit. A nuk e di ky – dhe ata si shembulli i tij – se shenjtëria e besimtarëve tek Allahu është e madhe?!

Ibën Umeri e pa Kaben (Qaben) dhe tha:

“Sa e madhe je ti! Dhe sa e madhe është shenjtëria jote! Porse, besimtari e ka shenjtërinë më të madhe tek Allahu se sa ti”.

Dhe për shkak të kësaj shenjtërie, Allahu – i Plotfuqishëm e i Madhëruar – zemërohet shumë (ashtu siç i takon madhërisë së Tij, sh.p) kur robi i Tij besimtar apo Umeti (populli) i Tij besimtarë dëmtohen me pa të drejtë. I Plotfuqishmi e i Madhëruari ka thënë:

وَالَّذِينَ يُؤْذُونَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ بَغَيْرِ مَا كَتَبْنَا فَقَدْ احْتَمَلُوا بُهْتَانًا وَإِثْمًا مُّبِينًا

² Ali Imran, 103.

“Ata të cilët i dëmtojnë besimtarët dhe besimtare, pa bërë ata ndonjë mëkat, me të vërtetë ata e kanë ngarkuar veten e tyre me një shpifje dhe mëkat të qartë”.³

Kanë mbartur shpifjen mbi kurrizet e tyre, e ajo shpifje është gënjeshtër e madhe. Gjithashtu, kanë mbartur mbi kurrizet e tyre mëkatën e qartë, d.m.th e qarta e dukshme, që njeriu nuk ka justifikim për kryerjen e saj. Pra, ata i lanë pas dore të drejtat e Allahut – të *Plotfuqishëm* e të *Madhëruar* – në ruajtjen e vëllazërisë besimtare, dhe i cënuan shenjtëritë e Allahut – të *Plotfuqishëm* e të *Madhëruar* – duke ua ngjitur dëmin vëllazërve të tyre muslimanë. Ndërsa, Pejgamberi – *Lëvdata dhe shpëtimi qoftë mbi të* – thotë:

“Nuk lejohet dëmtimi i vetes dhe as dëmtimi i të tjerëve”.

Andaj, përderisa nuk i vjen muslimanit nga ti ndonjë e mirë, atëherë të paktën ndaloje dëmin tënd ndaj tij.

Me të vërtetë, format e dëmtimit të besimtarëve po përhapen e po shtohen dhe po shpërndahen pak e nga pak. Çdo ditë po shohim ndonjë formë prej formave të dëmtimit të besimtarëve, që kryhen nga duart e disave që i atribuohen imanit dhe vëllazërisë në fe.

Dhe ato që e kanë dëmin më të madh prej tyre janë dëmtimi i besimtarit duke e akuzuar dhe duke i ngjitur atij atë gjë që e poshtëron atë para njerëzve, me diçka jo të vërtetë dhe me shpifje. Është vërtetuar nga Ebi Derda – *Allahu i Lartmadhëruar qoftë i kënaqur prej tij* – se ai ka thënë:

“Cilido njeri që përhap për një njeri musliman një fjalë për ta ofenduar me të, ndërkohë që ai është i pastër nga ajo, atëherë Allahu – i Plotfuqishëm e i Madhëruar – ka të drejtë që ta dënojë atë në zjarrin e Xhehenemit për shkak të saj, derisa të sjellë vërtetimin e asaj që e ka thënë.”

Këtë (hadith) e transmeton Ebu Shejh me zinxhir të saktë nga Ebi Derda, Allahu - i *Plotfuqishëm* e i *Madhëruar* – qoftë i kënaqur prej tij.

³ El-Ehzab, 58.

Kështu që, cenimi i shumtë i ndereve të muslimanëve, sidomos (cënimi i nderit) të atij që është nga mesi i dijetarëve, apo prej kërkuesve të dijes, duke shpifur dhe gënjyer për ta, si dhe duke u ngjitur atyre akuza të pavërteta, kjo është nga ajo që i kundërshton të drejtat vëllazërore, që janë vërtetuar me (argumentet) e prera të Sheriatit (*Legjislacionit*) Islamik, gjithashtu është cenim i qartë i kufijve të Allahut dhe i shenjtërive të Tij – *i Patëmeta e i Lartësuar*.

Prandaj, tolerimi në këtë çështje është një krim që nuk falet, derisa besimtari të pendohet prej saj dhe të kthehet tek Allahu – *i Patëmeta e i Lartësuar* –, si dhe të tregoj qëndrueshmëri në të. Ai që flet një fjalë që është mëkat kundrejt një dijetari apo një nxënësi të dijes, apo një burri musliman, apo një gruaje muslimane, ai është i barabartë me atë që e transmeton dhe e përhap atë pa e vërtetuar. Ashtu sikurse ka thënë prijësi i besimtarëve, Alij ibën Ebi Talib – *Allahu i Lartësuar qoftë i kënaqur prej tij* –, ashtu siç e ka transmetuar atë Ebu Shejh prej tij me zinxhir të saktë:

“Ai që shpif dhe ai i cili e zgjat litarin e saj (që e përhap atë) janë të njëjtë në mëkat.”

Gjithashtu, nga format e dëmtimit të muslimanëve është ajo që ndodh nga disa prej tyre, siç është të qenët krenar me përmendjen e të metave të tyre, me ndjekjen e turpeve të tyre dhe përhapja e tyre midis njerëzve, e kjo është nga krimet e mëdhaja për të cilat ka paralajmëruar Pejgamberi – *Lëvdata dhe shpëtimi qoftë mbi të* –. Gjithshtu, janë transmetuar vepra të Selefëve (të parëve tanë të mirë) duke iu larguar atyre dhe duke paralajmëruar nga ato. Disa sahabë kanë thënë – *Allahu i Lartmadhëruar qoftë i kënaqur prej tyre* – :

“Na është thënë se njerëzit me gjynahe më të shumta janë ata që kohën më të shumtë e kalojnë duke përmendur të metat e njerëzve.”

Po! Ata e kalojnë kohën duke i përmendur të metat e vëllezërve tyre muslimanë, ata s’kanë punë tjetër përveç cenimit të nderit të tyre dhe gjuatjes së gabimeve të tyre. Të tillët, Allahu – *i Plotfuqishëm e i Madhëruar* – i ka bërë që të bien në kurth për shkak të tyre, kështu që i ka bërë që të merren me të metat e njerëzve në vend që të merren me të metat e veta, dhe kjo është shenjë e zemërimit të Allahut – *të Përsosur e të Lartësuar* – me ta, ashtu sikurse ka thënë Bekr Ibën Abdilah El-Muzenij:

“Nëse e shikon një njeri që angazhohet duke u marr me të metat e njerëzve, duke harruar gabimin e vetes së tij, atëherë dije se ai vërtet ka rënë në kurth.”

E nëse Allahu – i Plotfuqishëm e i Madhëruar – i ngre kurth atij (si dënim për atë që vepron), atëherë ai me të vërtetë do të humb në luginat e devijimeve, shejtani do të veçohet me të dhe do ta hedhi në humnerat e shkatërrimit.

Për këtë arsye, Pejgamberi – *Lëvdata dhe shpëtimi qoftë mbi të* – ka njoftuar për ta në thënien e tij:

“Ndonjëri prej jush shikon glepën në syrin e vëllait të tij, kurse harron trungun pengues në syrin e tij.”

Pra, ata kanë një drejtues, të cilin e nxit shejtani për të gjuajtur gabimet dhe rënien në to, madje ata shikojnë dhe sendin e vogël që nuk shihet vetëm se me mikroskop apo diçka të tillë. E kjo është ajo për të cilën tregoi Pejgamberi – *Lëvdata dhe shpëtimi qoftë mbi të* – në thënien e tij:

“Ndonjëri prej jush shikon glepën në syrin e vëllait të tij.”

Ndërsa, glepa është ajo si floku apo diçka e tillë kur bie në sy. Kështu, ai u bë (*shkak*) që Allahu – i Plotfuqishëm e i Madhëruar – ta ndëshkonte atë rëndë, nga ku e bëri që të merret me ndjekjen e këtyre të metave dhe e bëri që të harrojë të metën e vetes së tij, që është shumë e madhe sikur trungu i hurmës, me qëllim që të meritohet kurthi i Allahut ndaj tij, në këtë mënyrë ai shkon tek Allahu – i *Lartësuar* – duke qenë i pa penduar nga ky gjynah, pa kërkuar falje për të.

Kështu që, o ju muslimanë! Frikësojuni Allahut – të *Plotfuqishëm e të Madhëruar* – për vëllazërinë në fe, dhe dijeni se ajo është nga mirësitë më të mëdhaja të Allahut – të *Plotfuqishëm e të Madhëruar* – ndaj jush, po ashtu dijeni se pohimi i saj është në Librin e Allahut, si dhe në Sunetin e të Dërguarit të Allahut – *Lëvdata dhe shpëtimi qoftë mbi të* –, ajo është bërë nga gjërat më të qarta tek shumica e muslimanëve. Prandaj, çdo kush që lexon Librin dhe Sunetin, dhe çdo kush që i shikon tekstet e Librit dhe Sunetit për këtë temë, do t’i bëhet e qartë atij se dashuria për hir të Allahut si dhe vëllazëria Islamike është një lidhëse e madhe dhe një bazë e madhe në Ligjin e Allahut – të *Përsosur e të Lartësuar* –.

Kështu që, kjo bazë nuk hiqet me gjëra hamendësuese dhe me mendime të rrejshme e të prishura vetëm se tek ata që Allahu – i *Plotfuqishëm e i Madhëruar* – ua ka mbuluar dhe ua ka vulosur zemrat e tyre, si dhe u ka vendosur në shikimet e tyre mbulesë, e si pasojë ata nuk udhëzohen me udhëzimin e Allahut – të *Plotfuqishëm e të Madhëruar* –, porse (*kërkojnë të*) udhëzohen vetëm me shpalljen e shejtanit. Na mbroftë Allahu- i *Plotfuqishëm e i Madhëruar* – neve dhe juve nga ai.

Allahu më begatofte mua dhe juve me Kur'anin Fisnik, dhe më dhëntë dobi mua dhe juve me ajetet dhe përkujtimin me urtësi që ka në të. E them këtë fjalën time dhe i kërkoj falje Allahut Madhështor e të Madhëruar për mua dhe juve, dhe për të gjithë muslimanët nga çdo gjynah. Kërkoni falje Atij dhe pendohuni tek Ai, me të vërtetë Ai është Falësi i Madh dhe Mëshiruesi.

Hutbeja e dytë:

Lavdërimi i takon Allahut për bamirësinë e Tij, dhe falenderimi i takon Atij për suksesin dhe begatitë e Tij. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, i Vetëm pa ortak, si madhërim për Madhësitinë e Tij, si dhe dëshmoj se pejgamberi jonë është Muhamedi, Lëvdata dhe shpëtimi i madh e Allahut qoftë mbi të mbi familjen dhe shokët e tij deri Ditën e Gjykimit.

E më pas:

O ju besimtarë! Me të vërtetë, qëndrimi i muslimanit ndaj gabimeve në të cilat bie vëllai i tij musliman është i sqaruar në Librin e Allahut të Lartmadhëruar, është i sqaruar në Sunetin e Mustafas (*të përzgjedhurit*) – *Lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – . Nëse muslimani bie në një mëkat, atëherë mbulimi i tij është i lavdëruar dhe i urdhëruar, për lidhjen e pëlqyeshme dhe forcimin. Besimtarët janë ata të cilët i mbulojnë (*mëkatet*), kurse hipokritët janë ata që i zbulojnë, ashtu sikurse ka thënë Fudajl Ibën 'Ijad – *Allahu qoftë i kënaqur prej tij dhe e mëshiroftë* – :

“Vërtet vepra e shëmtuar ecën në mesin e njerëzve derisa të vij tek njerëzit e mirë, atëherë ata bëhen vendruajtësit e saj (që të mos përhapet sh.p).”

Pra, kështu ishin Selefët – *Allahu qoftë i kënaqur prej tyre* – e mbulonin dhe e fshihnin atë çka transmetohej për një besimtar, ajo që e fyente atë (e që vinte) për shkak të kundërshtimit të Allahut – të *Plotfuqishëm e të Madhëruar* –, në mënyrë që shejtani të mos jetë ndihmë kundër vëllait tuaj, e si rrjedhojë të veçohet me të dhe ta humb atë në çdo luginë prej luginave të devijimeve.

Ndërsa, kur muslimani bie në një gabim që lidhet me Ligjin e Allahut – të *Plotfuqishëm e të Madhëruar* –, atëherë me të vërtetë është i urdhëruar që ta refuzojë këtë gabim, porse me rrugët që ka urdhëruar Allahu – *i Patëmeta e i Lartësuar* –, dhe të mos jetë refuzimi për fatin e vetes së tij dhe as për ta ndihmuar veten, porse të jetë mëshirë për të refuzuarin, me qëllim që t’i bëhet e qartë e vërteta. Gjithashtu, është mëshirë për njerëzit, me qëllim që të mos t’u pështjellohet atyre e vërteta nga e kota, e si pasojë të devijojnë. Pra, ky është qëllimi i dijetarëve me refuzimet, kështu që ata e ruajnë këtë synim dhe e preferojnë atë në çdo refuzim që e kryejnë.

Por ama, që refuzimet të jenë që thërrasin në urrejtje, në largim ndaj njëri-tjetrit dhe në armiqësi, që nuk sjellin korrigjim të gabimeve, porse vetëm shtojnë përçarje dhe ndarje, atëherë kjo është nga ajo që nuk e lavdërojnë dijetarët, dhe as nuk e duan atë midis Ehli-Sunetit dhe Xhematit.

Andaj, frikësojuni Allahut – të *Lartësuar* – o robër të Allahut, dhe ruani këto baza mbi të cilat kanë ecur Selefët (të Parët tuaj) – *Allahu qoftë i kënaqur prej tyre* –. Kështu që, ata realizuan prej thirrjes për tek Allahu dhe përhapjes së dijes, atë ç’ka nuk e realizuan të tjerët dhe nuk e gëzoi dikush tjetër përveç tyre.

Me kaq e përfundoj, dhe lutuni – *Allahu ju mëshiroftë* – për Pejgamberin tonë, Muhamedin – *Lëvdata dhe shpëtimi i Allahu qoftë mbi të dhe familjen e tij* –. Allahu – *i Plotfuqishëm e i Madhëruar* – ju ka urdhëruar juve që të luteni për të dhe ta përshëndesni me selam. Allahu – *i Plotfuqishëm e i Madhëruar* – ka thënë:

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

“Me të vërtetë Allahu dhe melaiket e Tij e lavdërojnë Pejgamberin. O ju të cilët keni besuar lutuni për të dhe përshëndeteni atë me selam”.⁴

O Allahu im, lavdëroje, shpëtoje dhe bekoje Pejgamberin tonë, Muhamedin, dhe Allahu qoftë i kënaqur me katër prijësat, Imamët Hunefa (*hunefa janë ata largohen prej shirkut për në Teuhid*) – Ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin dhe Aliun –, dhe me të gjithë shokët e Pejgamberit Tënd. Po ashtu, qofsh i kënaqur edhe me neve bashkë me ta, me nderin, bujarinë dhe bamirësinë Tënde, O më Bujari i bujarëve!

O Allah! Forcoje Islamin dhe muslimanët! Forcoje Islamin dhe muslimanët, dhe shkatërroi armiqtë e fesë, ndihmoi robërit e Tu, muahidinët (*ata të cilët e adhurojnë All-llahun të vetëm, pa i bërë ortak*), dhe bëje – O Allah – këtë vend të sigurtë, të qëndrueshëm e të qetë, dhe të gjithë vendet e muslimanëve.

O Allah! Na siguro në vendet tona, dhe përmirësoji imamët dhe prijësat tonë, O i Madhërishëm dhe Bujar!

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

“O Zoti ynë! Na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na mbro nga dënimi i zjarrit”.⁵

O robër të Allahut!

إِنَّ اللَّهَ يُأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

“Më të vërtetë Allahu urdhëron për drejtësi dhe bamirësi, si dhe për dhënie të afërmëve, si dhe ndalon veprat e shëmtuara, të keqen dhe dhunën. Ju këshillon në mënyrë që ju të përkujtoni”.⁶

⁴ El-Ehzab, 56.

⁵ El-Bekare, 201.

⁶ En-Nahl, 90.

Përkujtojeni Allahun e Madhërishëm dhe Madhështor që t'iu përkujtojë Ai juve, falenderojeni për të gjitha begatitë e Tij, që t'ua shtojë juve ato.

وَلَذِكْرُ اللَّهِ أَكْبَرُ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تَصْنَعُونَ

“E me të vërtetë përmendja e Allahut është më e madhja. Allahu di se çfarë bëni ju”.⁷

Burimi: <http://www.ajurry.com/vb/showthread.php?t=28380>

Perktheu: Altin Dallashi

⁷ El-Ankebut, 45.